



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren
Prizren Belediyesi

Memorandum Shpjegues për organizimin e dëgjimit publik me qytetarë, kryetarë/e të këshillave të lagjeve dhe fshatrave të Komunës së Prizrenit për hartimin e Buxhetit të Komunës për vitin 2027 dhe Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2028–2029

1. HYRJE:

Komuna e Prizrenit, në përputhje me parimet e transparencës, llogaridhënies dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje, organizon dëgjimin publik për hartimin e Buxhetit të Komunës për vitin 2027 dhe Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2028–2029.

Qëllimi i këtij dëgjimi publik është krijimi i mundësisë që qytetarët, kryetarët e këshillave të lagjeve dhe fshatrave, përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile, bizneset dhe grupet e tjera të interesit të paraqesin nevojat, prioritetet dhe propozimet e tyre lidhur me investimet kapitale, shërbimet publike dhe zhvillimin ekonomik e social të komunës.

Përmes këtij procesi synohet që planifikimi buxhetor të reflektojë sa më mirë kërkesat dhe interesin publik, duke siguruar një shpërndarje të drejtë, transparente dhe të qëndrueshme të mjeteve financiare komunale.

2. BAZA LIGJORE:

Organizimi i dëgjimit publik mbështetet në legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës, përkatësisht:

- Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale;
- Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet përkatëse;
- Ligjin Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, në pjesën që lidhet me planifikimin dhe menaxhimin e financave publike;
- Statutin e Komunës së Prizrenit;
- Rregulloren Komunale për Transparencë;
- Qarkoren Buxhetore 2027/01 të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për përgatitjen e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2027 dhe Kornizës Afatmesme Buxhetore 2028–2029;
- Aktet e tjera nënligjore që rregullojnë procesin e planifikimit buxhetor dhe konsultimit publik.

Këto dispozita obligojnë komunat që, gjatë përgatitjes së buxhetit, të sigurojnë pjesëmarrjen aktive të qytetarëve përmes organizimit të dëgjimeve publike, duke garantuar transparencë, informim dhe përfshirje të publikut në procesin e vendimmarrjes.

3. PËRMBAJTJA:

Në kuadër të procesit të hartimit të Buxhetit të Komunës së Prizrenit për vitin 2027 dhe Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2028–2029, Komuna e Prizrenit do të organizojë dëgjim publik me qytetarët, kryetarët e këshillave të lagjeve dhe fshatrave, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, komunitetit të biznesit dhe palëve të tjera të interesit.

Qëllimi i këtij dëgjimi publik është informimi i qytetarëve mbi procesin e planifikimit buxhetor, prezantimi i kufijve buxhetorë të përcaktuar me Qarkoren e Parë Buxhetore të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, si dhe mbledhja e propozimeve dhe prioriteteve të qytetarëve, të cilat do të shqyrtohen gjatë hartimit të Projekt-Buxhetit të Komunës për vitin 2027.

Sipas Qarkores së Parë Buxhetore, buxheti i planifikuar i Komunës së Prizrenit për vitin 2027 është 79,118,941 euro, i ndarë sipas kategorive ekonomike si vijon:

- Paga dhe mëditje – 33,885,952 euro;
- Mallra dhe shërbime – 15,230,224 euro;
- Shpenzime komunale – 1,205,299 euro;
- Subvencione dhe transfere – 5,531,785 euro;
- Investime kapitale – 23,235,681 euro.

Gjatë dëgjimit publik do të prezantohet struktura e këtij buxheti, orientimet kryesore të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2028–2029, si dhe prioritetet zhvillimore të Komunës së Prizrenit. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet investimeve kapitale, të cilat synojnë përmirësimin e infrastrukturës rrugore, objekteve publike, rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, arsimit, shëndetësisë, kulturës, sportit dhe fushave të tjera me interes për qytetarët.

Pjesëmarrësit do të kenë mundësi të paraqesin kërkesat, komentet dhe propozimet e tyre për investimet dhe shërbimet publike në lagjet dhe fshatrat e Komunës së Prizrenit. Të gjitha rekomandimet e paraqitura do të evidentohen në procesverbal dhe do të shqyrtohen nga Drejtoria për Ekonomi dhe Financa, në bashkëpunim me drejtoritë komunale, në përputhje me prioritetet zhvillimore, mundësitë financiare dhe dispozitat ligjore në fuqi.

Për të garantuar transparencë dhe pjesëmarrje sa më të gjerë, dokumentet përkatëse, përfshirë Qarkoren Buxhetore dhe Kornizën Afatmesme Buxhetore, do t'u shpërndahen pjesëmarrësve dhe do të publikohen në ueb-faqen zyrtare të Komunës. Organizimi i këtij dëgjimi publik synon të sigurojë një proces të hapur, transparent dhe gjithëpërfshirës, duke mundësuar që buxheti i vitit 2027 të reflektojë sa më mirë nevojat dhe prioritetet e qytetarëve të Komunës së Prizrenit.

4. PËRFUNDIMI:

Organizimi i dëgjimit publik për hartimin e Buxhetit të Komunës për vitin 2027 dhe Kornizës Afatmesme Buxhetore 2028–2029 përbën një ndër mekanizmat më të rëndësishëm të demokracisë lokale, transparencës institucionale dhe pjesëmarrjes qytetare.

Përmes këtij procesi, Komuna e Prizrenit synon të sigurojë që planifikimi buxhetor të jetë gjithëpërfshirës, transparent dhe i orientuar drejt nevojave reale të qytetarëve, duke respektuar parimet e menaxhimit të mirë financiar dhe obligimet ligjore në fuqi.

Propozimet dhe rekomandimet e paraqitura gjatë dëgjimit publik do të shqyrtohen me kujdes dhe, varësisht nga mundësitë buxhetore, përputhshmëria me dokumentet strategjike dhe prioritetet komunale, do të inkorporohen në Projekt-Buxhetin e Komunës për vitin 2027 dhe Kornizën Afatmesme Buxhetore 2028–2029.

Ky memorandum shërben si dokument shpjegues për organizimin e dëgjimit publik dhe si bazë për zhvillimin e procesit konsultativ në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet e qeverisjes së mirë.